



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:124943

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05436649

PPP.nr.136/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi, në çështjen juridike të kreditorit ProCredit Bank, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: “R.1.” NPT, me seli Lipjan, rr “...”, me përfaqësues I.B., H.B. nga Ferizaj, rr “...”, nr...., F.B. nga Ferizaj dhe Y.H. nga fsh ..., Komuna e Ferizajt, për pagesën e borgjit, kredisë, duke vendosur për prapësimin e debitorit H.B., me datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit H.B., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.2726/19, të datës 22.10.2019, të lëshuar nga Përmbaruesi privat V.B. nga Prishtina dhe **MBETET në fuqi** urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.2726/19, i datës 22.10.2019.

A r s y e t i m

Me urdhrin për përmbarim P.nr.2726/19, të datës 22.10.2019, Përmbaruesi privat V.B., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori ProCredit Bank, kundër debitorëve: “R.1.” NPT, me përfaqësues I.B., H.B., F.B. dhe Y.H., për pagesën e borgjit, kredisë, në shumë prej 51,531.71 euro, në bazë të kontratës së hipotekës Vr.nr.2305/11, të datës 18.04.2011, si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrin për përmbarim, debitori H.B., brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit H.B., me të cilën i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë çështje të përmbarimit i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarim P.nr.2726/19, të datës 22.10.2019 dhe pretendimet në prapësim të debitorit H.B. dhe pas vlerësimit të pretendimeve vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri mbi lejjimin e përmbarimit P.nr.2726/19, i datës 22.10.2019, i lëshuar nga përmbaruesi privat V.B., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, ngase përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin në pajtim të plotë me dispozitat e nenit 22, par 1, nën par 1.7, të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

Sa i përket pretendimeve të debitorit H.B. në prapësim se kjo çështje të mbyllet në aspektin e paluajtshmërisë sepse debitorja F.B. ka vdekur dhe nuk jeton më, Gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar sepse me aktvendimin PPP.nr.136/22, të datës 11.03.2024, në pajtim me nenin 35, par 4, të LPP-së, në emër të trashëgimtarëve të debitores F.B., e ka caktuar trashëgimtarin e debitores B.B.

Gjithashtu, sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se në këtë rast gjendja faktike e pronës është tjetër nga ajo që është përshkruar dhe fillimisht parcela e hipotekuar është sipërfaqe e ndërtuar dhe jo tokë bujqësore sepse në këtë rast kemi të bëjmë edhe me dëmtimin e kundërligjshëm të personave tjerë, kjo hapësirë e hipotekuar ka edhe persona tjerë që jetojnë dhe në këtë çështje banka ka bërë gabim kur ka vendosur që kjo pronë të hipotekohet sepse ka familje të cilat nuk kanë qenë në dijeni s prona e tyre do të hipotekohet, gjykata këto pretendime i konsideron të pabazuara sepse gjatë vendosjes lidhur me prapësimin e ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, gjykata nuk ka tagër të bëjë hetim të fakteve apo të gjendjes faktike se si ka ardhur deri tek lidhja e kontratës së hipotekës, gjegjësisht ligjshmërinë e lidhjes së kontratës së hipotekës sepse një gjë e tillë mund të bëhet vetëm në procedurën kontestimore gjatë vendosjes lidhur me padinë eventuale të ushtruar nga palët Përndryshe, gjykata në këtë rast ka për detyrë vetëm ta bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së urdhrin për përmbarim. Për më tepër, kontrata e hipotekës, e cekur më lart, në bazë të cilës është nxjerrë urdhri për

përmbarrim, në bazë të nenit 22, par 1, nën par 1.7, të LPP-së, konsiderohet dokument përmbarrimor në bazë të cilit organi përmbarrues mund ta caktoj përmbarrimin.

Andaj, gjykata duke i marr parasysh thëniet e debitorit H.B. në prapësim, thëniet e kreditorit në përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarrim P.nr.2726/19, i datës 22.10.2019, të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.136/22, më datë 11.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.